



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Punëve te Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs  
Akademia e Kosovës për Siguri Publike  
/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety



## KUADRI I ZHVILLIMIT STRATEGJIK AKSP 2023 - 2026



# Misioni AKSP 2023 – 2026

„ Misioni i Akademisë është të ofroj trajnim, arsimim dhe hulumtim me cilësi të lartë në fushën e sigurisë publike për të ndihmuar në ofrimin e ambientit të sigurte për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës “

Misioni i AKSP-së në vete i përgjigjet pyetjes se pse ekziston ky institucion, , shqyrton kujdeshëm çka dhe nivelin e shërbimit që ofron, cilin segment të komponentës mbulon dhe përcakton grupin e synuar. Misioni është një nga pjesët themelore të planifikimit dhe baza për ndërtimin e një plani strategjik të suksesshëm. Arsimi i mirëfilltë nxit ngritjen profesionale dhe intelektuale të zyrtareve të sigurisë e kjo kontribuon në zhvillimin e shoqërisë dhe ofrimin e ambientit të sigurte për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës

Me rastin e përcaktimit të misionit të AKSP-së për vitet e ardhshme si dhe rrugën të cilën duhet ndjekur përmes shtyllave kryesore të saj janë marrë në konsideratë shumë elemente por më kryesore janë : Përgjegjësia, Shërbimet e ofruara, Cilësia, Kompetenca, Komuniteti

**Përgjegjësia:** AKSP është përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike. (Ligin Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP)

**Shërbimet:** Krijimi dhe avancimi i programeve trajnuese dhe studimore konformë nevojave të Institucioneve të Sigurisë Publike të cilat ndihmojnë ngritjen e kapaciteteve dhe sigurisë publike në vend.

**Cilësia:** Cilësia është faktor kyq dhe i qëndrueshëm i zhvillimit të kapaciteteve ku AKSP përmes standardeve dhe praktikave akredituese të jetë e hapur ndaj ndryshimeve bazuar në informatat kthyese të palëve të interesit dhe raporteve akredituese.

**Kompetenca:** Ofrimin e nivelit të lartë të kompetencave për autoritetet e zbatimit të ligjit për të iu përgjigjur sfidave vazhdimesh të ndryshueshme në fushën e sigurisë publike. Trendët e kriminalitetit çdo herë ndryshojnë për nga forma dhe mënyra e shfaqjes andaj edhe adaptimi i programeve trajnuese dhe arsimore duhet adaptuar konformë këtyre ndryshimeve.

**Komuniteti:** AKSP synon që përmes ngritisës së kapaciteteve profesionale të zyrtareve të Institucioneve të Sigurisë Publike ndikon në ofrimin e një ambienti të sigurte për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

„ Misioni i Akademisë është të ofroj trajnim, arsimim dhe hulumtim me cilësi të lartë në fushën e sigurisë publike për të ndihmuar

në ofrimin e ambientit të sigurte për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës “



**Përgjegjësia** - AKSP merr përgjegjësin që i takon për zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike për Institucionet e Sigurisë Publike

**Shërbimet** - AKSP ofron trajnime , arsimit të lartë dhe hulumtime në fushën e sigurisë publike për Institucionet e Sigurisë Publike konformë nevojave të Institucioneve të Sigurisë Publike të cilat ndihmojnë ngritjen e kapaciteteve dhe sigurisë publike në vend.

**Kompetenca** - ofrimin e nivelit të lartë të kompetencave për autoritetet e zbatimit të ligjt për të iu përgjigjur sfidave vazhdimisht të ndryshueshme për ofrimin e një ambienti të sigurte për të gjithë qytetarët e vendit



**Cilësia** – cilësia është faktor kyq dhe i qëndrueshëm i zhvillimit të kapaciteteve ku AKSP përmes standardeve dhe praktikave akredituese të jetë e hapur ndaj ndryshimeve bazuar në informatat kthyese të palëve të interesit

**Komuniteti** - AKSP synon që përmes ngritjes së kapaciteteve profesionale të zyrtareve të Institucioneve të Sigurisë Publike ndikon në ofrimin e një ambienti të sigurte për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

# Vizioni AKSP 2023 – 2026

„Akademia përmes ofrimit të trajnimeve dhe arsimimit me cilësi dhe standarde të ekselencës do të jetë faktor kyç në ngritjen e kapaciteteve të zbatuesve të ligjit konformë ndryshimeve dhe sfidave me të cilat përballën”

Me rastin e përcaktimit të vizionit të AKSP-së për vitet e ardhshme, janë marrë në konsideratë shumë elemente por më kryesore janë : Aspekti ligjor, Akreditimet, Përgjegjësia dhe Programi QRK 2021-2025

## I. Aspekti Ligjor - Mandati

Akademia e Kosovës për Siguri Publike është institucion i formuar me Ligjin Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (më tutje Akademia), përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike.

Akademia ofron trajnime dhe arsim të lartë për të gjitha institucionet e sigurisë publike por pa u kufizuar vetëm në:

- ✓ Policinë e Kosovës;
- ✓ Shërbimin Korrektues;
- ✓ Shërbimin Sprovues;
- ✓ Doganën e Kosovës;
- ✓ Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;
- ✓ Inspektoratin Policor të Kosovës.

## II. Akreditimet vendore dhe Ndërkontëtare të AKSP

Akademia e Kosovës për Siguri Publike me qëllim të validimit dhe akreditimit të programeve trajnuese dhe arsimore i është nënshtruar disa proceseve vlerësuese nga ana e Institucioneve të ndryshme vendore dhe ndërkontëtare ku si rezultat ka arritur të marrë edhe validimet dhe akreditimet si vijon:

- Validimi i trajnimeve profesionale për të gjitha agjencionet e sigurisë publike që veprojnë në AKSP ( 6 trajnime profesionale PK, IPK, DK, SHKK, AME SHSK) nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve


- Akreditimi i programit studimor të arsimit të lartë „Bachelor Siguria Publike“ nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.
- Akreditimi Ndërkombëtar Institucional nga IADLEST-SHBA me *çmimin e ekselencës*

### III. Marrja e Përgjegjësisë

Akademia e Kosovës për Siguri Publike bazuar në mandatin ligjor si dhe duke pasur një mision të qartë, do të përkushtohet me përgjegjësi të lartë në trajnimin dhe arsimimin e zbatuesve të ligjit bazuar në cilësinë, praktikat dhe standarde e ekselencës si faktor kyç në ngritjen e kapaciteteve të zbatuesve të ligjit. Pra në mënyrë që t'i avancoj aftësitë dhe shkathtësitë për të gjithë pjesëtarët e Institucioneve të sigurisë publike që t'i përgjigjen sfidave, trendëve dhe fenomeneve potenciale që mund të paraqiten në fushën e Sigurisë Publike.

### IV. Programi Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021 - 2025

Programi i Qeverisë pasqyron qasjen dhe parimet që do të ndiqen për realizmin e vizionit të saj. Në kuadër të këtij dokumenti tek fusha Rendi dhe siguria publike parashev ngritjen e kapaciteteve profesionale, modernizimin e pajisjeve etj me qëllim që t'i përgjigjen sfidave, trendëve të krimit dhe fenomeneve negative në fushën e Sigurisë Publike.



# VIZIONI AKSP 2023 - 2026

**Aspekti Ligjor** - AKSP është institucion përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike për Institucionet e Sigurisë Publike

**Vizioni**

„Akademia përmes ofrimit të trajnimeve dhe arsimimit me cilësi dhe standarde të ekselencës do të jetë faktor kyç në ngritjen e kapaciteteve të zbatuesve të ligjit konformë ndryshimeve dhe sfidave me të cilat përballen“

**Akreditimet** - AKSP ka arritur akreditimin ndërkontrollor me çmimin e ekselencës ku synon që përmes praktikave dhe standardeve të arritura të ngrit kapacitetet e ISP-ve. AKSP-ja ka arritur **nivelin e krahasimit** me nivelet ndërkontrollore

**Përgjegjësia** - AKSP-ja është e përkushtuar që të mbetet në rrjedha në kuadër të fushës së saj të përgjegjësisë dhe ta jetësojë në praktikë vlerësimin dhe informatat kthyese. AKSP do të përkushtohet me përgjegjësi të lartë në trajnimin dhe arsimimin e zbatuesve të ligjit bazuar në cilësinë, praktikat dhe standarde e ekselencës si faktor kyç në ngritjen e kapaciteteve të zbatuesve të ligjit.

**Programi Qeveris** - AKSP-ja është e përkushtuar të dëgjojë dhe të jetë e ndikuar nga prioritet e Qeverisë, MPB-së, Institucioneve të Sigurisë Publike dhe partnerëve ndërkontrollorë me qëllim që t'i përgjigjen sfidave, trendëve të krimit dhe fenomeneve negative në fushën e Sigurisë Publike

# VLERAT E AKSP-së 2023-2026

AKSP-ja ka të përcaktuara edhe vlerat e sajë të cilat jo vetëm i prezanton por edhe i ndjenë si të tilla duke i përkthyer në kulturë organizative dhe pjesë rutinë e çdo procesi të punës. Stafi i AKSP-së do të shfaq nivel të lartë të vlerave të tyre duke u mbështetur në **ndershmëri, transparencë, përgjegjësi, etikë profesionale dhe diversitet**.

**NDERSHMËRIA** - Nga secili anëtar pritet të veprojë ndershmërisht në aspektin e punës dhe në jetën private. Kjo është më se e nevojshme dhe e domosdoshme për të bërë të mundshme dhe të realizueshme që AKSP të bëhet model i institucioneve publike. AKSP po ashtu në mënyrë të dukshme do të demonstrojë ndershmëri në proceset vendimmarrëse të saj

**TRANSPARENCA** - Të gjitha proceset e AKSP-së: planifikimet, vendimmarrjet, vlerësimet, raportimet dhe të arriturat duhet të janë tërësisht transparente për të gjithë palët e interesit në theks të strukturës, argumenteve dhe përgjegjësisë.

**PËRGJEGJËSIA** - AKSP fuqimisht demonstron se do të mbajë përgjegjësi të plotë për nivelin e kompetencës së të diplomuarve. Brenda AKSP-së, secili anëtar i saj do të bartë dhe mbajë përgjegjësi për rezultatet të cilat rrjedhin nga veprimet dhe vendimet e tyre

## Vlerat e AKSP

- **Ndershmëria**
- **Transparenca**
- **Përgjegjësia e demonstruar**
- **Etika profesionale**
- **Diversiteti**

**ETIKA PROFESIONALE** - AKSP vë theksin mbi rëndësinë thelbësore në angazhimin e saj te të gjitha nivelet e arsimimit, te praktikat më të mira profesionale dhe vlerat organizative. AKSP si institucion do të jetë shembull në këtë aspekt.

**DIVERSITETI** - AKSP është e përkushtuar për të njojur, vlerësuar dhe respektuar ndryshimet e të tjera e kulturat e tyre si një mjedis që promovon dhe feston arritjet individuale dhe kolektive.

# QËLLIMET STRATEGJIKE AKSP

1. Zhvillimi i kapaciteteve synohet të arrihet përmes programeve trajnuese të certifikuara dhe akredituara, trajnimeve të avancuara dhe specializuara, programeve të arsimit të lartë duke i përshtatur ato sipas sfidave aktuale, praktikave dhe standardeve vendore dhe ndërkombe.

2. Përdorimi i standardeve vendore dhe ndërkombe të cilësisë duke siguruar certifikimin dhe akreditimin e programet trajnuese dhe arsimore përmes vendosjes së mekanizmave për monitorim dhe vlerësim të cilësisë duke integruar edhe metodat e reja pedagogjike për ti bërë programet e krahueshme me praktikat më të mira ndërkombe.

3. Krijimi i rrjetit të partneriteteve me institucionë dhe organizata vendore dhe ndërkombe homologe për shkëmbimin e praktikave me qëllim të identifikimit të fushave për përmirësim konformë praktikave dhe përvojave më të suksesshme për të arritur nivelin e krahasimit me vendet perëndimore.

## Qëllimet Strategjike AKSP

1. Zhvillimi i kapaciteteve për Institucionet e sigurisë publike duke ofruar kompetencën e nevojshme për të reaguar ndaj sfidave vazhdimesh të ndryshueshme;
2. Ngritura e cilësisë për shërbimet e ofruara duke u bazuar në standardet dhe kriteret e akreditimeve vendore dhe ndërkombe;
3. Avancimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit vendor dhe ndërkombetar me qëllim të krahasimit dhe shkëmbimit të praktikave më të mira;
4. Krijimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore që plotëson nevojat e zbatimit të misionit AKSP-së;
5. Avancimi i shërbimeve, pajisjeve dhe infrastrukturës konformë standardeve ndërkombe.

4. Rritja e nivelit të vazhdueshëm të profesionalizmit përmes mekanizmave për vlerësimin e performancës dhe motivimit, duke krijuar një kulturë organizative dhe transparente nga rekrutimi, zhvillimi dhe bashkëpunimi.

5. Përmes modernizimit të vazhdueshëm të shërbimeve, pajisjeve dhe infrastrukturës së AKSP-së, duke i përafruar ato me standardet ndërkombe dhe duke i përshtatur me nevojat konkrete trajnuese dhe arsimore. Investimi në teknologji të reja, përmirësimi të kushteve të mësimdhënies dhe trajnimit, si dhe krijimi i hapësirave funksionale që lehtësojnë procesin e të nxenit

# OBJEKTIVAT STRATEGJIKE AKSP

1. Ngritja e kapaciteteve të sigurisë publike do të realizohen përmes trajnimeve të hartuara konformë praktikave dhe standardeve të akreditimit vendor dhe ndërkombëtar si dhe përmes shkëmbimit të përvojave me Institucionet më të mira të relevante.

2. Ofrimi i kompetencës profesionale zyrtarëve të sigurisë publike përmes arsimit të lartë duke rishikuar dhe adaptuar programin studimor konformë politikave të mirëfillta shkencore, cilësisë së mësimdhënies, trendëve arsimore dhe nevojave të institucioneve të sigurisë publike për të iu përgjigjur sfidave vazhdimisht të ndryshueshme

3. Fokusi i hulumtimeve është orientuar drejt rrjetëzimit dhe hapjes së mundësive për hulumtuesit e rinj si studentëve, bashkëpunëtoreve dhe zyrtareve të ISP-ve, rritjen e partneritetve ne vend dhe jashtë për të sjellë dhe ndarë potencialin hulumtues nga fusha e sigurisë publike.

## Objektivat strategjike

1. Ngritja e kapaciteteve profesionale të institucioneve të sigurisë publike përmes ofrimit të programeve trajnuese të standardizuara
2. Avancimi i arsimit të lartë në siguri publike
3. Zhvillimi i profilit Hulumtues në shërbim të sigurisë publike
4. Avancimi i sistemeve te menaxhimit te cilësisë sipas standardeve bashkëkohore në zbatimin e politikave te sigurimit te cilësisë dhe procesit te përmirësimit
5. Përmirësimi i kornizës ligjore dhe menaxhim efikas i burimeve njerëzore, infrastrukturore dhe proceseve të punës në përputhje me praktikat dhe standarde më të mira
6. Fuqizimi i bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar si dhe rritja e kredibilitetit të AKSP

4. Ngritja e cilësisë do të bazohet në përmirësimin e vazhdueshëm sipas standardeve ndërkombëtarisht të njohura. AKSP-ja është e përkushtuar që të mbetet në rrjedha dhe ti jetësojë në praktikë vlerësimin dhe informatat kthyese

5. AKSP-ja për ofrimin e shërbimeve cilësore ka paraparë krijimin e një infrastrukturë bashkëkohore dhe moderne, digitalizimin e shërbimeve, ngritjen e kapaciteteve dhe përcaktimin e procedurave dhe politikave menaxhuese në AKSP.

6. Shkëmbimi i praktikave dhe përvojave përmes bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar bënë që AKSP-ja të arrin nivelin e krahasimit edhe me vendet perëndimore. Kjo arrihet përmes promovimit dhe inkurajimit të personelit dhe zyrtarëve të sigurisë publike për pjesëmarrje dhe shfrytëzim të programeve të këmbimit